

Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prizdato Received/Deliverty	07.02.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOR	575/2022		1/3

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.1233/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1233/2021 të datës 30.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme, në çështjen juridike "kerkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 07.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1233/2021 të datës 30.12.2021 të parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar MPJD), me datën 30.12.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 6426/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( tutje referuar Këshilli), kundër heshtjes administrative të Zyrës së Personelit dhe Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me sistemimin tim të përhershëm në pozitë de jure inekzistente brenda MPJD-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 14.01.2021, ka dorëzuar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa me datë 19.01.2022 Këshilli më ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 236/2022 së bashku me shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 6426/2021 të datës 30.12.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 01.11.2021; Formularin PDP mbi përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i depos" E-mailin zyrtar të datës 05.11.2021; E-mailin zyrtar të datës 02.04.2021; Vendimin me numër Nr.Ref.77/2021 të datës 02.04.2021; E-mailin zyrtar të datës 06.12.2021; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.25/2021 të datës 07.04.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.01.2022 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli të datës 236/2022 datës 19.01.2022 nga Ministria e Punëve të Jashtme me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me numër A.nr.356/2021 të datës 14.06.202, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1233/2021 të datës 30.12.202, të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Vendimit me numër Nr.ref.77/2021 të datës 02.04.202, të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, është sistemuar në pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Logjistikës, në Departamentin për IT dhe Logjistikë. Ankuesi i pa kënaqur me këtë sistemim, me datë 30.04.2021, ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ndërsa, ky i fundit me datën 14.06.2021 përmes Vendimit me numër A.nr.356/2021, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar, duke lënë në fuqi Vendimin me nr.ref.77/2021 të datës 02.04.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Ankuesi me datën 05.11.2021 dhe 06.12.2021, paraqet kërkesë të Zv. Sekretarja e Përgjithshme e MPJD-së për rishikimin e vendimit Nr.ref.77/2021 të datës 02.04.2021, ndërsa ankuesi serish kundër vendimit të njëjtë, me datën 30.12.2021 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin që Këshilli ta obligoj zv.Sekretaren e Përgjithshme të MPJD-së, që ta rishikoj dhe anuloj vendimin për sistemin e tij të përhershëm me nr. ref.77/2021 të datës 02.04.2021, që de jure është inekzistente dhe ankuesin ta sistemoj në një pozitë tjetër në pajtim me kualifikimet e tij.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në rrethanat si me lartë, vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1233/2021 i datës 30.12.2021 është i njëjtë me objektin e ankesës së ankuesit të datës 30.04.2021, për të cilin Këshilli kishte vendosur në mënyrë meritore me datën 14.06.2021 përmes Vendimit A.nr.356/2021, gjegjësisht ankuesi atakon vendimin e njëjtë duke u bazuar në qëllimin dhe gjendjen e njëjtë faktike, kështu që nisur nga ky konstatim dhe në kuptim të dispozitave të nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktikë..," Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.1233/2021 të datës 30.12.2021 të parashtruar nga ankuesi




Kështu që, bazuar në rrethanat si me lartë, si dhe mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1233/2021

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivitet të KPMShCK-së.